



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 18 mars 2019
Nr. ref.:RK 1337/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI136/18

Parashtrues

Fisnik Emini

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,
PML. nr. 173/2018, të 16 korrikut 2018**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzie Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Fisnik Emini nga fshati Radivojce, komuna e Vitisë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme PML. nr. 173/2018 të 16 korrikut 2018.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) dhe nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).
4. Përveç kësaj, parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese të vendosë masë të përkohshme.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 27 [Masat e përkohshme] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe rregullat 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] dhe 56 [Kërkesa për masë të përkohshme] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 14 shtator 2018, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
7. Më 19 shtator 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Remzie Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
8. Më 29 shtator 2018, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Me të njëjtën shkresë, Gjykata kërkoi nga parashtruesi që ta plotësojë kërkesën duke parashtruar formularin e plotësuar të kërkesës dhe duke dorëzuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme PML. nr. 173/2018 të 16 korrikut 2018.
9. Më 5 dhjetor 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme PML nr. 173/2018 të 16 korrikut 2018 Me këtë shkresë parashtruesi kërkoi nga Gjykata të vendosë masë të përkohshme.
10. Më 14 dhjetor 2018, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi në Gjykatë formularin e plotësuar të kërkesës.
11. Më 18 dhjetor 2018, Gjykata ia dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

12. Më 7 shkurt 2019, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Më 6 korrik 2014, ndodhi një aksident në trafik ku një nga aktorët e aksidentit ishte parashtruesi i kërkesës.
14. Më 11 shtator 2014, Prokuroria Themelore në Gjilan ngriti akt padi kundër parashtruesit të kërkesës për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale të rrezikimit të sigurisë në trafik dhe shkaktimit të aksidentit në trafik.
15. Më 5 maj 2017, Gjykata Themelore në Gjilan me Aktgjykimin P. nr. 555/2014, e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për veprën penale të rrezikimit të sigurisë në trafik dhe shkaktimin e aksidentit në trafik dhe i shqiptoi dënimin me gjobë.
16. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit (PP. nr. 555/2014) të Gjykatës Themelore, *“për shkak të shkeljeve të rënda të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit për dënim.”*
17. Më 4 korrik 2017, Gjykata e Apelit me Aktvendimin PA1. nr. 721/2017 aprovoi ankesën e parashtruesit të kërkesës, anuloi Aktgjykimin (PP nr. 555/2014) e Gjykatës Themelore dhe e ktheu çështjen në të njëjtën gjykatë për rivendosje.
18. Më 2 mars 2018, Gjykata Themelore në Gjilan në procedurë të përsëritur me Aktgjykimin P. nr. 338/2017, e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për veprën penale të rrezikimit të sigurisë në trafik dhe shkaktimit të aksidentit të trafikut dhe i shqiptoi dënimin me gjobë.
19. Në një datë të pacaktuar, kundër Aktgjykimit (PP. nr. 338/2017) të Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës dhe Prokuroria themelore parashtruan ankesë në Gjykatën e Apelit *“për shkak të shkeljeve të rënda të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit për dënim.”*
20. Më 14 maj 2018, Gjykata e Apelit me Aktgjykimin PA1. nr. 436/2018 e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe prokurorisë themelore dhe e vërtetoi në tërësi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore (PP. nr. 338/2017).
21. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit (PA1. nr. 436/2018) të Gjykatës së Apelit, *„për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal me propozim që që aktgjykimet e kontestuara të ndryshohen në lidhje me gjobën e shqiptuar ose të shfuqizohen dhe çështja të kthehet në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim.”*

22. Më 16 korrik 2018, Gjykata Supreme (me Aktgjykimin Pml. nr. 173/2018), e refuzoi kërkesën e parashtruesit për mbrojtjen e ligjshmërisë si të pabazuar. Në arsyetimin e aktgjykimit, Gjykata Supreme thekson:

“Gjykata konstaton se të dyja gjykatat kanë dhënë arsye të mjaftueshme ligjore në lidhje me vlerësimin e rrethanave në bazë të të cilave është shqiptuar vendimi për dënim dhe gjithashtu gjykata e shkallës së dytë ka arsyetuar të gjitha pretendimet ankimore dhe në veçanti pretendimet lidhur me vlerësimin e rrethanave lehtësuese të paraqitura në ankesë, dhe si arsye të drejta i vlerëson edhe kjo gjykatë. Përveç kësaj, në ankesën e parashtruar kundër aktgjykimit të shkallës së parë, i dënuari duke u ankuar në vendimin për dënim nuk i theksoi fare rrethanat e tjera lehtësuese që nuk ishin vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë dhe prandaj ankesa e tij ishte refuzuar.”

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

23. Parashtruesi i kërkesës nuk ka treguar saktësisht se cilat të drejta dhe liri themelore i janë shkelur me aktgjykimin e kontestuar. Parashtruesi vetëm përmend nenin 6 të KEDNJ-së dhe nenin 141 të Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPK).
24. Përveç kësaj, parashtruesi kërkon nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme, duke arsyetuar, *“Kërkoj që të vendoset masa e përkohshme në lidhje me pagesën e dënimit me gjobë që është urgjente për shkak të kushteve të mija sociale ekonomike.”*
25. Parashtruesi i kërkesës shpjegon se me aktgjykimet e kontestuar, *“janë shkelur rend dispozitat ligjore në dëm të akuzuarit, CENIM i REND i Konventës Evropiane, të drejtat e njeriut, si dhe të drejtave të garantuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.”*
26. Në fund, parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës me kërkesë që, *“të aprovohet kërkesa TË MARR FILLIMISHT MASË TË PËRKOSHME NDAJ TRE AKTGJYKIMEVE për mos Egzekutim të Aktgjykimve dhe lënda të PRISHET duke e kthyer në rigjykim të shkallës së parë, dhe të OBLIGOJ shkallën e parë në respektim të çdo dispozite ligjore për gjitha palët në procedur.”*

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

27. Gjykata së pari vlerëson nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të specifikuar me Ligj dhe të parapara më tej me Rregullore të punës.
28. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

„1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

(...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

29. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë siç parashihet me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa Individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët parashohin:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

„1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individit mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.“

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë.”

Neni 49 [Afatet]

„Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor... .”

30. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës e ka parashtruar kërkesën në cilësi të palës së autorizuar, duke kontestuar aktin e autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin [PML. nr. 173/18] e 16 korrikut 2018 të Gjykatës Supreme, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike të parapara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu e parashtroi kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
31. Megjithatë, me rastin e vlerësimit nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kërkesat e pranueshmërisë të parapara me Ligj, Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili i parasheh obligimin e parashtruesit të kërkesës që në kërkesën e tij të dorëzuar në Gjykatë të specifikojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon të jenë shkelur.
32. Kriteri i njëjtë është përshkruar qartë edhe në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (1) (d), parasheh:

“(1) Gjykata mund ta konsideroj një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

(d) kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.“

33. Rrjedhimisht, Gjykata thekson se në mënyrë që të konsiderohet se kërkesa i plotëson kriteret e pranueshmërisë, parashtruesi i kërkesës është i obliguar të tregojë me saktësi në kërkesën e tij se cilat të drejta dhe liri i janë shkelur dhe që në mënyrë adekuate të paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave kushtetuese ose dispozitave.
34. Parashtruesi i kërkesës nuk ka specifikuar se cilat të drejta dhe liri ai pretendon se i janë shkelur me një akt të një autoriteti publik, përkatësisht me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [PML. nr. 173/18] të 16 korrikut 2018, të cilin ai e konteston në Gjykatë. Parashtruesi në kërkesë përmend vetëm nenin 6 të KEDNJ-së dhe nenin 141 të KPK-së pa i shpjeguar saktësisht faktet dhe pretendimet për shkeljen e të drejtave kushtetuese.
35. Në rrethanat e këtij rasti, kërkesa e parashtruesit është në pajtim me kriteret e parapara në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 të Kushtetutës dhe nenet 47 dhe 49 të Ligjit. Megjithatë, kërkesa e parashtruesit nuk i plotëson kriteret e pranueshmërisë siç parashihet në nenin 48 të Ligjit dhe pikën (d) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës.
36. Në përfundim, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (d) të Rregullores së punës, kërkesa është e papranueshme.

Vlerësimi i kërkesës për masë të përkohshme

37. Gjykata vëren se parashtruesi në kërkesë kërkon që Gjykata të vendosë masë të përkohshme.
38. Për të lejuar masën e përkohshme, në pajtim me rregullin 57 (1) të Rregullores së punës, Gjykata duhet të konstatojë që:

“(1) Nëse Gjyqtari raportues konsideron që kërkesa e paraqitur është e papranueshme, atëherë kërkesa për masë të përkohshme do të shqyrtohet së bashku me kërkesën bazë sipas renditjes së vendosjes së kërkesave në Gjykatë. Nëse Gjyqtari raportues konsideron që kërkesa është e pranueshme, atëherë kërkesa për masë të përkohshme do të procedojë me shpejtësi.“

39. Siç është konkluduar më parë, kërkesa është e papranueshme, prandaj nuk ekziston rasti *prima facie* për vendosjen e masës së përkohshme. Për këto arsye, kërkesa për masë të përkohshme duhet të refuzohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në mbështetje të nenit 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, nenit 48 të Ligjit dhe të rregullave 39 (1) (d) dhe 57 (1) të Rregullores së punës, më 7 shkurt 2019, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TA REFUZOJË njëzëri kërkesën për masë të përkohshme.
- III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Radomir Laban

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi

